



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

RAPORT MONITORIMI I ZBATIMIT TË BUXHETIT NR. 1

Mbi Ecurinë Financiare Buxhetore të AMSHC-së për 4-mujorin e parë të vitit 2017

Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, mbështetur në ligjin Nr.130, date 15.12.2016 “Për Buxhetin e Vitit 2017”, dekretuar me dekretin e Presidentit Nr.9905, datë 23.12.2016, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.8, dt.13.01.2017 “Për zbatimin e Buxhetit të Vitit 2017”, i është akorduar një fond i planifikuar prej 122 milione e 500 mijë lekë, i detajuar si më poshtë vijon:

Tabela 1 (ne Leke)

Fondi i Pagave:	13,000,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	2,500,000 leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	5,000,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	101,000,000 Lekë (zeri 604)
Fondi per Investimet e Trupezuara:	1,000,000 Lekë (zeri 231)
TOTAL	122,500,000 LEKE

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore në 76,820,861 Leke nga totali prej 122,530,000 Leke ose **62.69%** të fondit të planifikuar vjetor.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe te VKM “Për përcaktimin e numrit të Punonjësve me kontratë të Përkohshme për vitin 2017 në njësitë e qeverisjes qendrore”.

Gjatë 4- mujorit të parë të vitit 2017, numri mesatar i punonjësve është realizuar 15 punonjës faktik, si dhe një punonjës me kontratë të përkohshme.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, për këtë periudhë, është realizuar respektivisht:

4,340,095 Lekë (zeri 600) për paga, realizimi **33%**.

706,973 Lekë (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore, realizimi **28.2%**.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), për vitin 2017, është planifikuar në vlerën **5,000,000 leke**.

Edhe për këtë zë, periudha Janar – Prill 2017 është realizuar vlera prej **1,153,793 Lekë** **pra 23.7% e planit vjetor**.

Gjithashtu, në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me:

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve dhe prokurimeve të mallrave dhe shërbimeve për nevoja të AMSHC, publikime, blerje kancelarike, shërbim i pastrimit të institucionit etj.
- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitore dhe të tretë, të mbartura nga 2016.
- Krijimin e facilitetit për Udhetime pune jashtë vendit dhe brenda vendit me fokus rritjen e kapaciteteve të stafit si dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira me vendet e rajonit dhe më gjërë.

Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (zëri 604), për vitin 2017 është planifikuar në vlerën **101,000,000 leke**.

Ky është dhe zëri më me peshë në strukturën e buxhetit të AMSHC-së, duke qenë se dhe vete misioni i këtij institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet të OJF-ve përfituese si dhe mbështetjen teknike të OSHC-ve në vend.

Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **70,590,000 Lekë** ose **69.89%** e planit vjetor.

Në realizimin e këtij zëri, AMSHC-ja ka vazhduar me disbursimet e mbetura të Thirrjes 8 dhe Thirrjes 9 ndërkohë është në proces vlerësimi dhe nënshkrimi kontratash edhe Thirrja Nr.10 që pritet të disbursohet në muajt në vijim sipas kontratave.

Fondi per shpenzim investime (zeri 231) ,

1,000,000 Lekë (zeri 231) për Investime të Trupëzuara, realizimi ka qënë 0 lekë pasi për projektin e blerjes së pajisjeve kompjuterike janë duke u bërë shkresat e nevojshme për marrjen e miratimit nga AKSHI dhe më tej do fillojë procedura e prokurimit për këto pajisje.

AMSHC, ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Date 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", si dhe legjislacionin administrativo-financiar shqiptar.

Drejtore Ekzekutive

ANDI KANANAJ

RAPORT I MONITORIMIT FINANCIAR (katër mujori i parë 2017)

Formati nr.6: Raporti i Shpenzimeve Faktike te Programit sipas Artikujve.

Periudha Janar - Prill 2017

Ne Leke

Grupi		88			
Emri i Grupit	AGJENCIA PER MBESHTETJEN E SHOQERISE CIVILE	Kodi	1110		
Programi	Mbeshtetje per Shoqerine Civile	Titulli			
		Shpenzimet e AMSHC			
Programet		PBA	Buxhet 2017	Fakti	Diferenca
Titulli	Emri	Plan 2017	Plani I rishikuar gjate vitit	2017	2017
600	Paga	13,000,000	13,000,000.0	4,340,095	8,659,905
601	Sigurime Shoqerore	2,500,000	2,500,000.0	706,973	1,793,027
602	Shpenzime operative	5,000,000	5,000,000.0	1,153,793	3,846,207
603	Subvencione	0	0.0		
604	Transferta korrente te brendshme (Kap 1)	101,000,000	101,000,000.0	70,590,000	30,410,000
604	Transferta korrente te brendeshme (Kap 6)		0.0		0
605	Transferta korrente te huaja	0	0.0		0.0
606	Trans per Buxh. Fam Ind	0	0.0	30,000	-30,000.0
Nen Totali Shpenzime korrente		0	0.0		0.0
230	Kap te Patrupezuara	0	0.0		0.0
231	Kapitale te Trupezuara	1,000,000	1,000,000.0	0	1,000,000.0
232	Transferta Kapitale	0	0.0		0.0
Nen Totali Shpenzime kapitale		0	0.0		0.0
		0	0.0		0.0
Totali Korrente + Kapitale		122,500,000	122,500,000.0	76,820,861	45,679,139.0
Jashte Buxhetore		0	0	0	0
TOTALI (Korrente + kapitale + jashte buxhetore)		0	122,500,000.0	76,820,861.0	45,679,139.0

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Leonida Hasa	Sekretari i Përgjithshëm/Titullari i Institucionit	Emri	Andi Kananaj
	Firma			Firma	
	Data			Data	